



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Emërtimi i Modulit: INTERPRETIMI JURIDIK A-B. B-A

(sipas KSHK 7, Kualifikim për të nxënëit gjatë gjithë jetës 3, Programet e studimeve të formimit të vazhduar)

Programi i Formimit të Vazhduar : “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”

Lloji i Trajnimit: Trajnim i drejtpërdrejtë, nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime.

Gjuha e përdorur në mësimdhënie: “Gjuha e burimit” *anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.*

“Gjuha e synuar” *anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.*

Kohëzgjatja e programit të modulit: 30 orë

Nr. i krediteve: 3 ECTS

Mënyra e zhvillimit: Orë praktike në laboratorin e interpretimit

REZULTATET E TË NXËNIT:

Ky modul synon t’u japë përfituesve njohuri teorike dhe praktike për mënyrat e ndryshme të interpretimit të konferencës dhe t’i aftësojë studentët në interpretimin e konferencës në fushën juridike dhe synon t’u shpjegojë strukturën e sistemeve juridike (e drejta penale, administrative dhe e drejta civile) dhe rolin e interpretit brenda tyre.

Moduli synon t’i nxitë përfituesit të vënë në zbatim terminologjinë ligjore në mënyrë të saktë dhe të përshtatshme si në gjuhët burimore ashtu edhe në ato të synuara dhe të bëjnë interpretime në mjedise të ndryshme ligjore, duke përfshirë sallat e gjyqit, arbitrazhet, seancat gjyqësore, qendrat e emigrantëve dhe të azilit dhe intervistat në rajonet e policisë.

Të trajnuarit synohet të përftojnë aftësi në tre mënyrat e interpretimit (interpretim i njëkohshëm, konsektiv dhe me shikim) në kontekstin ligjor; të përdorin teknikat e marrjes së shënimeve dhe të kujtesës për të përmirësuar saktësinë dhe koherencën e interpretimit;

Moduli synon t’u mësojë përfituesve si të respektojnë standardet profesionale të etikës dhe konfidencialitetit, duke përdorur kodet e njohura të sjelljes (AIIC, NAJIT, etj.); si të menaxhojnë stresin dhe dinamikën komplekse gjatë situatave të interpretimit që kanë ngarkesë emocionale;

Të trajnuarit pajisen me aftësi për të marrë pjesë në gjyqe dhe aktivitete të simuluar, duke demonstruar gatishmëri për detyra të interpretimit ligjor të botës si dhe për të thelluar punën e tyre në kërkimin shkencor për interpretimin;

Moduli është praktik, në laborator ku të trajnuarit zhvillojnë simulime të konferencave ku vënë në praktikë aftësitë e tyre në interpretimin simultan dhe të atij me fletë. Nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme, synohet që përfituesit të përmirësojnë aftësitë e tyre të kuptuarit të saktë të mesazheve, të menduarit, përpunimit logjik të tyre, të krijimit dhe ruajtjes së fjalorit të terminologjisë ligjore, duke përfshirë barazvlerësit në të gjitha gjuhët dhe sistemet ligjore.

OBJEKTIVAT E MODULIT:

Të pajisë interpretët me aftësitë, njohuritë e duhura për të punuar në mënyrë efektive në mjediset ligjore dhe gjyqësore;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Të drejtojë të trajnuarit të zhvillojnë teknika të avancuara të interpretimit (interpretim simultan, konsektiv, me shikim) të përshtatura posaçërisht me kontekstet ligjore;

Të familjarizojë të trajnuarit me sistemet ligjore, procedurat dhe terminologjinë në juridiksione të ndryshme;

Të nxitë profesionalizmin, neutralitetin dhe saktësinë në skenarët e interpretimit ligjor;

t'i ndihmë të trajnuarit të krijojnë elasticitet dhe inteligjencë emocionale për interpretim në kontekste ligjore të ndjeshme ose traumatike;

t'u japë përfituesve njohuritë e duhura mbi nivelet e ndryshme të zbërthimit të ligjëratave si hap themelor në përkthimin e tyre me gojë.

t'i njohë të trajnuarit me teknikat dhe procedurat bazë e të avancuara të interpretimit simultan, konsektiv;

të aftësojë të trajnuarit të përmirësojnë aftësitë analizuese të mesazhit;

të prezantojë dhe të aplikojë modelet e ndryshme të interpretimit;

të zhvillojë aftësitë e duhura të marrjes së shënimeve dhe të riformulimit të mesazheve duke interpretuar e bashkërenduar shënimet dhe kujtesën;

të zhvillojë aftësitë e duhura për kujtesën afatshkurtër dhe afatgjatë për rrjedhshmërinë e riformulimit; të bëjë ekuivalencën e duhur kur flitet për terminologjinë juridike;

të zhvillojë aftësitë për të transmetuar në mënyrë efikase stilin, regjistrin, dhe qëllimin e folësit si dhe brendinë dhe kontekstin;